



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

REVOKIM AKTESH E TË TJERA

(ZGJIDHJE KONTRATE)

Nr. repertori: 2013

Nr. koleksioni: 718

Tirane më 09/04/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2022050620071279422



REVOKIM KONTRATE

(KONTRATË DHURIMI AKSIONESH SHOQËRIA "ALBANIA GAS TECH" SH.A.)

Sot, më datë 28/04/2022, para meje Notere Ardjana A. Mediu, Anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën: Tiranë, Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqitën personalisht:

PALËT:

- **Z. Shefit Kastrati**, atësia Jonuz, amësia Lihe, shtetas shqiptar, lindur në Brrut, Kukës dhe banues në Durrës, me adresë: Rr. "Taulantia" 00690806; Nd. 45/1; H. 4; Ap. 26; 2025; Durrës, lindur më 22/07/1970, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 036479571 dhe Nr. Personal H00722126W.
- **Z. Gani Kastrati**, atësia Nebi, amësia Beglie, shtetas shqiptar, lindur në Brrut, Kukës dhe banues në Tiranë, me adresë: Rr. "Dervish Hima"; Nd. 2; H. 1; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1003; Tiranë, lindur më 15/11/1952, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar prej meje me Letërnjoftim ID Nr. 037179509 dhe Nr. Personal F21115099P, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Shoqërisë "**KASTRATI GROUP**" SH.A, me nr. NUIS K21711502V.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 690 e vijues, Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", neni 62, pika 1, gërma "II", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues, bien dakort dhe kërkojnë nga Unë Noterja hartimin e këtij "Akti për Revokim Kontrate", sipas kushteve dhe përcaktimeve të mëposhtme:

DUKE QENË SE:

- Më datë 30.03.2021, është nënshkruar Kontratë Dhurimi Aksionesh me Nr.1619 Rep dhe Nr.491 Kol nga Z. Shefit Kastrati në cilësinë e Dhuruesit dhe Shoqërisë KASTRATI GROUP SH.A. në cilësinë e Pranuesit të Dhurimit, me objekt: "Kalimin e së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit, nga Dhuruesi të Pranuesi i Dhurimit, të 13,174.5 aksioneve, përfaqësues të 50% të kapitalit, që Dhuruesi Z. Shefit Kastrati, zotëronte në Shoqërinë "ALBANIA GAS TECH" SH.A., me nr. NUIS L11718501C.



A2022050620071279422

Palët deklarojnë se nëpërmjet këtij akti bien dakort të revokojnë Kontratën e Dhurimit të Aksioneve me Nr.1619 Rep dhe Nr.491 Kol datë 30.03.2021, duke u kthyer në gjëndjen e mëparshme.

Nëpërmjet këtij akti, palët deklarojnë se heqin dorë e nuk kanë e nuk do të kenë asnjë pretendim të tashëm apo të ardhshëm, nga Kontrata e Dhurimit të Aksioneve me Nr.1619 Rep dhe Nr.491 Kol datë 30.03.2021, si dhe nga efektet financiare e ligjore të saj përgjatë gjithë periudhës që kjo kontratë ka qënë në fuqi.

Revokimi i kontratës u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e tij dhe meqenëse ky akt shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e tij juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALET

Z. Shefit Kastrati

Shefit Kastrati
[Signature]

Shoqëria "KASTRATI GROUP" SH.A

Përfaqësuar nga:

Z.Gani Kastrati

[Signature]



NOTERE

ARDJANA A. MEDIU